

VENDIM
Nr.146, datë 18.3.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.822, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR SHITJEN ME ANKAND TË HOTEL "TIRANA INTERNATIONAL ""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, të Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.822, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ky ndryshim:

- Shkronja "a" e pikës 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Punonjësit e shoqërisë "DV-ALBTURIST HOTELIERS" sh.p.k., që do të dalin të papunë, si rrjedhojë e shitjes së objektit, t'u jepen si shpërblim përfundimtar, 12 paga mujore, duke marrë si bazë pagën mesatare të secilit për vitin 2003."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano